



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

P. nr.918/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti I përgjithshëm- me Gjyqtaren Diana Sina, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit L.(K.) M.nga fsh.O. P. K.Gj., sipas Aktakuzës të PTH-DP në Gjakovë, PP.nr.1112/2017 të datës 06.12.2017, për shkak të veprës penale, rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-ës, duke vendosur në lidhje me propozimin për dhënien e urdhër ndëshkimor me datën **30.03.2018**, murr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-DP në Gjakovë, PP.nr.1112/2017 e datës **06.12.2017** dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I A K U Z U A R I

L.M., i biri i K.-s dhe H.-s, data e lindjes..., fsh.O. P.K.Gj., ku edhe tani banon, me nr. personal i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës.

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse: Me datë 30.07.2017 rreth orës 12.40 min, ne rrugën regjionale Gj.-K. ne hyrje te fsh. Q. komuna e Gj., rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 53 te Ligjit per rregullat e trafikut rrugor dhe vene ne rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyre që nga pakujdesia edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund te shkaktohet si rezultat i veprimit të tij ose mosveprimit të tij, por me mendje lehtësi mendon se ajo nuk do te shkaktohet apo se ai do te mund te parandaloj shkaktimin e saj, ashtu që duke drejtuar automjetin e tij kamionin e markës “....” nuk mban distancën e duhur, nuk iu përshtat kushteve te rrugës derisa ishte ne një kolonë, në pamundësi që të ndalet, e godet me pjesën frontale veturën tjetër pjesëmarrëse te markës “M...” të cilën e drejtonte Z. L. dhe te njëjtën e hudh mbrapa tek vetura tjetër e markës “M.B. ” të cilën e drejtonte F. N., ku si rrjedhoje shkaktohen

dëme materialë dhe lëndime te lehta trupore të konstatuara dhe të përshkruara me hollësisht sipas ekspertizës mjeko-ligjore te dt.01.12.2017.

- me çka ka kryer veprën penale, rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 prg. 6-1 të KPRK-ës.

Andaj, Gjykata komfor nenit 4,41,43,46,73 dhe neni 378 prg. 6-1 të KPRK-ës , dhe nenit 495 të KPPK-ës, të akuzuarit,

I SHQIPTON

Dënim me gjobë në shumën prej 300.**-(Treqind).-€**, të cilën dënim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **15(pesëmbëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.-€.(njëzet) euro, të gjobës**.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00.-Euro, në emër të Akt ekspertimit mjeko-ligjor të paguaj shumën prej 20,00 Euro, dhe në emër të ekspertizës të komunikacionit të paguaj shumën prej 40.88€** ,e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Të dëmtuarit S.S. L. dhe F. M. N. që të dytë nga fshati M. Komuna Gj. dhe Z.L.nga fshati B. Komuna Gj., kompensimin e dëmit mund ta realizojnë në kontest civil.

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore-Departamenti i përgjithshëm në Gjakovë, ka ngritur Aktakuzë PP.nr.1112/2017 të datës 06.12.2017, kundër të akuzuarit L.M. nga fsh.O.P. për shkak të veprës penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6-1 të KPRK-ës, me propozim që ndaj të akuzuarit ti jepet urdher ndëshkimor dhe të njëjtit ti shqiptohet dënimi me gjobë pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 të KPPK-ës gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 378 par. 6-1 të KPRK-ës dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH-DP në Gjakovë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe ti shqiptoi ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palën e pa udhëzuar është e nevojshme që ti referohet dispozitës së nenit 378 par. 6-1 të KPRK-ës e cila dispozitë për kryesin e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet.

Gjykata vlerëson se provat që janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrit ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Ekspertiza mjeko-ligjore me nr.... e dt.23.11.2017 e lëshuar nga eksperti mjeko-ligjor Dr. F.D.
- Ekspertiza e komunikacionit e dhënë nga Ingj. J. M.e dt. 07.10. 2017
- Raporti i hetuesit mbi aksidentin e trafikut,lidhur me rastin, A. K. i dt.30.07.2017.
- Skica e vendit të ngjarjes.
- Deklarata e të akuzuarit e dhënë në Stacionit policor në Gjakovë me dt.30.07.2017.
- Deklarata e të dëmtuarve L. Z. ,F. N.,S.L. të dhënë në Stacionit policor në Gj. me dt.30.07.2017.
- Raporti i emergjencës të Spitalit rajonal në Gjakovë për lëndimet e marruar të dëmtuarve.
- Foto-dokumentacioni si dhe shkresat tjera ne lende

Gjykata, këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtin do te arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-ës, në mënyrë që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën paragraf 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
Departamenti i përgjithshëm
P. nr.918/17 më datë 30.03.2018.**

**Sekretarja juridike,
Lamije Kuqi**

**Gj y q t a r j a,
Diana Sina**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi i akuzuari dhe mbrojtësi i tij mund të ushtroj Kundërshtim, në afat prej **8** ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjyqtares të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:031092
Datë: 17.08.2018
Numri i dokumentit: 00103095